



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 26

Datë: 04. 10. 2022. Ora: 13: 30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Alim Rama, Ilir Gashi, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj dhe Rifat Krasniq.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Nexhmedin Hyseni, drejtor i ZRPP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes Nr. 24 dhe 25/2022.**
- 3. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së**
- 4. Aktivitetet e ZRPPC-së:**
 - **Rekomandim për pezullimin e partisë politike Stranka Demokratske Akcije**

- 5. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

- 2.1 Këshilli për Çështje Ligjore:**

2.1 Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për kandidatin e radhës për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për zëvendësimin e deputetes znj. Vafije Blair, nga SP LVV

3.1.Këshilli për Operacione Zgjedhore;

3.1 Shqyrtimi dhe miratimi i Agjendës “Punëtori për Identifikimin e Shtyllave dhe Synimeve Strategjike”.

Te ndryshme !

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kreshnik Radoniqi: E hapi mbledhjen nr. 26, me rend të ditës që e keni. Mbasi që kryetari Radoniqi e paraqiti agjendën e mbledhjes, pyeti se a ka ndonjë propozim tjetër për takimin... Në të ndryshme, unë kam nja dy – tri çështje që do t’i ngris...

Burim Ahmetaj, e informoi KQZ-në për ftesën e ardhur nga IFES-i (zyra regjionale) për mbajtjen e një punëtorie. Duhet një vendim i KQZ-së...

Kreshnik Radoniqi: Mirë, mirë, le të hyjë kjo dhe ftesa tjetër që na ka ardhur mua dhe ty Burim për udhëtim në Zvicër, pra i vendosim në rendin e ditës...

Miratohet rendi i ditës me 11 vota për, dhe pastaj miratohen edhe dy procesverbalet nga mbledhjet e KQZ –së, nr. 24, dhe nr. 25/2022.

2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së

Burim Ahmetaj, në rezymenë e tij informative për anëtarët e KQZ-së, tha se SKQZ, sipas obligimeve të veta që ka në raport me plani vjetor i punës, është në fazën e raportimit tre (3) mujor lidhur me zbatimin e planit të punës së KQZ-së për vitin 2022 që do të përfshijë periudhën janar-tetor 2022 si dhe raporte financiare dhe të shpenzimeve tjera. Departamentet dhe Njësitë do të raportojnë në Sekretariat më së deri me 7 tetor, kur Sekretariati do të shqyrtoj raportet para se ti dërgoj në KQZ. Në fund të vitit, KQZ-ja do të hartojë Planin e Punës për vitin 2023, andaj në lidhje me këtë kam kërkuar nga të gjitha Departamentet dhe Njësitë që të fillojnë me planifikimin e aktiviteteve që do të përfshihen në draft planin e punës së KQZ-së 2023. Draft plani i punës së KQZ-së për vitin 2023 do të bazohet edhe në strategjinë e KQZ-së 2023-2026 ku disa nga aktivitetet do të mund të përfshihen në draft Planin e Punës për vitin 2023.

Ahmetaj, po ashtu tha se në fund të vitit 2022, Sekretariati obligohet të përgatis planin preliminar të prokurimit, dhe meqenëse përpos aktiviteteve të prokurimit të planifikuar me buxhetin për vitin 2023,

disa nga aktivitetet e planit të punës do të mund të kenë kosto buxhetore dhe kam kërkuar nga Sekretariati, që të përgatisin projektet të cilat do të përfshihen në planin preliminar të prokurimit (dhjetor 2022) dhe planin përfundimtar të prokurimit (janar 2023).

Në vazhdim, z. Ahmetaj raportoi lidhur me aktivitetin nr. 35, “Tjetërsimi i pasurive jo financiare të KQZ-së nëpërmjet shitjes dhe donimit”. Ai bëri të ditur se, SKQZ ka ndërmarrë veprime për ti përgatitur materialet për donacion dhe tjetërsimin përmes ankandit publik. Sekretariati, ka draftuar Udhëzimin Administrativ për tjetërsimin e pasurisë jo financiare, i cili pritet të dërgohet në njërin prej këshillave të KQZ-së për shqyrtim dhe miratim ashtu si e parasheh neni 4.1. i Rregullores se pasurisë financiare te MF 02/2013. Rregullorja obligon Organizata Buxhetore të nxjerrin aktet e tyre për tjetërsimin e pasurisë jo financiare. Në vitin 2015 Sekretariati ka nxjerrë udhëzimin administrativ për Inventarizimin e pasurisë (nr. 930-2015).

Në draft, UA për tjetërsimin e pasurisë jo financiare të KQZ-së janë specifikuar format e tjetërsimit: Në rast të humbjes dhe vjedhjes, asgjësimi i materialit zgjedhor – bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, shitja - saktësimi i procedurës së ankandit publik përmes prokurimit, dhe mënyra dhe forma e donimit të pasurisë jo financiare. Gjithashtu, tha z. Ahmetaj, aktiviteti i planit të punës nr. 11 “Shkatërrimi i materialeve te ndjeshme zgjedhore nga Zgjedhjet Lokale të mbajtura në vitin 2021” ka qenë paraparë të zhvillohet gjatë muajve mars-maj 2022. Sekretariati ka zhvilluar procedurën e Prokurimit për këtë aktivitet dhe për të përkrahur këtë aktivitet, në selektimin e materialeve të cilat janë ruajtur me kërkesë të Prokurorisë së Shtetit (PSh) , PZAP dhe KQZ-së, si dhe sistemimin e materialeve nga proceset tjera zgjedhore 2013-2021, përveç komisionit mbikëqyrës për shkatërrimin e materialit zgjedhor që përfshinë edhe ZLKZ janë angazhuar edhe 5 staf me meditje. Procesi i shkatërrimit të materialit të zgjedhjeve ka filluar me 09 shator 2022.

Në lidhje me mbikëqyrjen e asgjësimit të materialit zgjedhor të zgjedhjeve lokale 2021, ju njoftoj se është duke vazhduar puna në selektimin e kutive dhe asgjësimin e materialeve. Kanë mbetur edhe një numër i vogël i kutive të cilat duhet të kontrollohen edhe asgjësohen dhe krahas kësaj është duke vazhduar procesi i shkatërrimit të Formularëve zgjedhor (FPR, FRK), Lista Votuese dhe Libra të votimit. Po ashtu, tha Ahmetaj, formularët zgjedhor dhe Librat e votimit janë të skanuara. Materialet e shkatërruara deri ditën e hënë të javës së kaluar, janë tërhequr nga Operatori Ekonomik dhe janë peshuar, ku 18,870 kg ka qenë pesha e tyre.

Gjithashtu, z. Ahmetaj e njoftoi KQZ-në edhe mbi strategjinë e KQZ-së për vitet 2023-2026. Ai, tha se Grupi Punues për hartimin e strategjisë së KQZ-së 2023-2026, i përbërë nga Sekretariati, ka mbajtur takim e

radhës me 03 tetor 2023. Nën Grupi Punës, ka për detyrë përgatitjen e punëtorisë për shtyllat strategjike, prezantimet, si dhe draftimin e dokumenteve që identifikon shtyllat, veprimet, aktivitetet, ndërlihdjen e shtyllave strategjike me bazat strategjike (Misioni, Vizioni dhe parimet). Nëngrupi do të zhvillojë konsulta edhe me stafin e Sekretariatit për të përfshirë veprimet strategjike që përfshijnë objektivat, aktivitetet strategjike dhe indikatorët. Grupi, do të bëjë hartimin e këtij dokumenti të cilin do të prezantojë në punëtori. Aktivitete tjera të planit të Punës, siç janë Hartimi i Strategjisë për trajnimin e Trupave Menaxhuese Zgjedhore si dhe analizimet e vendvotimet e rinumëruar, trendet zgjedhore, janë në proces e sipër.

Në kuadër të zbatimit të Planit të Prokurimit, shumica e aktiviteteve janë implementuar me përjashtim të aktiviteteve të prokurimit për sigurimin fizik të objekteve të KQZ-së, furnizimit me Inventar dhe pakot e fund vitit të cilat janë në proces. Nga Ministria e Administrimit së Pushtetit Lokal në bashkëpunim me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) , KQZ është ftuar në punëtorinë e përbashkët me qëllim të finalizimit të Koncept Dokumentit për Ligjin Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës. Punëtorja, është mbajtur me datë 27-28 Shtator 2022, në Restaurant “Villa Gërmia” në Prishtinë. Për detaje nga kjo punëtori KQZ do të njoftohet në një mbledhje të radhës, përfundoi kryeshefi, Burim Ahmetaj.

Sami Kurteshi, pyeti se si qëndron puna rreth procesit të rregullave, pastaj për Komitetin e Auditimit ku pyeti rreth pagesës së anëtarëve të KO-së. Gjithashtu, ai pyeti edhe mbi lëndët që janë marrë nga prokuria dhe gjykatat rreth rastet nga proceset e votimit. Nuk kemi raport se çka ndodhë në këtë drejtim: janë mbyllë lëndët, ka hetim, gjykim...pra, ne nuk kemi informacione të këtilla, së paku unë nuk kam, përfundoi Kurteshi.

Alim Rama: Në mbledhjen e kaluar kemi diskutuar se në rastin e një operatori nuk është bërë pagesa, dhe lënda ka shkuar te përmbaruesi. Unë mendoj se, duhet një shpjegim se pse ka shkuar te përmbaruesi kur ne kemi pasur buxhet...Ka qenë e planifikuar, pse me shkuar te përmbaruesi...

Po ashtu, rreth kutive jemi informuar dhe se na është thënë se janë kryer. Është shumë me rëndësi të informohemi, dhe të lirohemi nga ato kuti...Të kemi statistika të sakta...

Burim Ahmetaj, u përgjigj në pyetjet e shtruar nga anëtarët e KQZ-së, dhe për rregullat tha se, ato rregullat zgjedhore janë kryer të gjitha, veç atyre të Zyrës...të tjerat, të gjitha janë harmonizuar...

Për anëtarët e KO-së, tha se ai, ka bërë autorizimin e pagesave...Kurse, rastet e Prokurorive rreth kutive, janë 10-12 kuti nga zgjedhjet e vitit 2012 dhe se ato kanë arritur parashkrimin absolut, por ende nuk kemi

përgjigje se si të veprojmë, apo ta ndjekim praktikën e njëjtë...Rastet e 2013 ende i ruajmë. Edhe pse një pjesë e lëndëve kanë aktgjykimin e prerë..., do ta përgatisim një raport për këto...dhe, të lirohemi edhe nga këto kuti, apo lidhur me statusin e tyre...

Ju njoftoj, tha Ahmetaj se gjykatat janë duke u marrë me lëndët e zgjedhjeve 2017 dhe 2019. Ndëra, rreth aktivitetit të prokurimit, pra fjala është për furnizimin me Laptop, është fjala për një laptop që ka pasur vlerën më shumë se 1000 euro... (Ahmetaj, e shpjegoi se pse ka ndodhur “përmbarimi”, duke e përgatitur edhe një raport, ndonëse lënda, tha ai, tashmë është në përmbarim dhe mjetet do të merren, sepse furnizimi është bërë...).

Sami Hamiti, kërkoi që lënda të mos prapësohet – sepse, nuk duhet thënë që “ska ndodh diçka”, pra le të paguhet... Gjithashtu, z. Hamiti, kritikoi çështjen e gjendjes së pagesave dhe tha se, këtu nuk ka se çka diskutohet se, është punë ligjore...

Kreshnik Radoniqi, kërkoi që po ashtu, të bëhet një listë çka është hudhë poshtë tek lëndët që kanë të bëjnë me proceset e votimit, çka është bërë e plotfuqishme në mënyrë që, me ditë me u nda kutitë për shkatërrim, pra kjo të bëhet...

Z. Radoniqi, kritikoi përvojën e “kallximeve penale për 3 – 4 vota ose ndonjë gabimi teknik”, sepse ato hidhen dhe për rastet e këtilla nuk ka kuptim të bëhen kallxime penale... Pra, të bëhet një analizë e thellë...

Sami Kurteshi: Po më duket pa lidhje: ne informohemi, por unë nuk jam i informuar. A duhet i kemi njoftimet nga prokuroria, gjykatat...Për këto elemente, ne duhet të njoftohemi, të diskutojmë...

Ibrahim Selmanaj, kërkoi që komunikimi i brendshëm të rritet, të raportohet, mos të rriten çështjet por të zvogëlohen...

3. Aktivitetet e ZRPPC-së:

Rekomandim për pezullimin e partisë politike “Stranka Demokratske Akcije” (SDA)

Valmira Selmani, zyrtare e ZRPPC-së, e informoi KQZ-në lidhur me monitorimin e Kuvendit të I (parë) - Zgjedhor të partisë politike “GUXO”. Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim, tha Selmani e ka monitoruar kuvendin e mbajtur më 07.09.2022 në Prishtinë. Kuvendi i Partisë Politike Guxo, është thirr për tu mbajtur në pajtim me nenin 14 të Statutit të Partisë, dhe ka pasur kuorum të duhur për zhvillimin

e punimeve. Sipas listës së dorëzuar me nënshkrimet e delegateve pjesëmarrës. Lidhur me këtë kuvend, Zyra në mbledhjen e radhës do të raportojë lidhur me rrjedhën dhe vlerësimet ligjore.

Valmira Selmani, e ka njoftuar KQZ-në mbi atë se pas afatit shtesë të lejuar nga KQZ për (PAI-n), me datë 6 shtator 2022, Zyra ka pranuar ftesë për kuvendin e rregullt zgjedhor nga Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI). Nga raporti i monitorimit të Zyrës dhe duke u bazuar në rrjedhën e punimeve të Kuvendit dhe implementimit të procedurave, Zyra konstaton se Kuvendi zgjedhor i partisë politike (PAI) janë bërë në përputhje me Statutin e Partisë dhe Rregullat e KQZ-së. Materiali nga partia në fjalë është dorëzuar në Zyrë brenda afatit ligjor, duke përfshirë raportin e kuvendit, statutin dhe listën e delegateve pjesëmarrës.

Gjithashtu, më datën 24 shtator 2022, ZRPP ka pranuar ftesë edhe për kuvendin e rregullt zgjedhor nga Partia Politike “Kosovaki Nevi Romani Partia” (KNRP). Zyra, e njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se, Kuvendi i mbajtur me datën 2 tetor 2022 në Prizren. Nga raporti i monitorimit të Zyrës dhe duke u bazuar në rrjedhën e punimeve të Kuvendit dhe implementimit të procedurave, Zyra konstaton se Kuvendi zgjedhor i partisë politike (KNRP) janë bërë në përputhje me Statutin e Partisë dhe Rregullat e KQZ-së. Ndërsa, materialin nga partia në fjalë është duke pritur në Zyrë brenda afatit ligjor prej pesë (5) ditëve, duke përfshirë raportin e kuvendit, statutin dhe listën e delegateve pjesëmarrës, ka thënë Selmani.

Zyra, sipas Selmanit, e ka njoftuar KQZ-në se Partia politike “Stranka Demokratske Akcije”, e regjistruar më 21 gusht 2000 me kryetar z. Numan Baliq, ka bërë kërkesë për shtyrje të afatit të fundit për mbajtjen e kuvendit zgjedhor me datë 25 janar, 2022. Zyra ka rekomanduar KQZ-në për shtyrjen e afatit të fundit të Kuvendit zgjedhor të kësaj partie për shkak të gjendjes pandemike, dhe për shkak të masave kufizuese në lidhje me tubimit. KQZ, e ka miratuar rekomandimin e Zyrës dhe kësaj partie, me vendim nr.178/2022 të datës 28.01.2022, i ishte dhënë afat deri me 18 shtator, 2022. Duke pasur parasysh që kjo parti politike nuk ka respektuar afatin e fundit të dhënë nga KQZ për mbajtjen e Kuvendit, Zyra ka rekomanduar që kjo parti politike të pezullohet në përputhje me Rregullën 01/2013 për Regjistrimin dhe veprimin e partive politike, më saktësisht neni 6.1 pika a) duke iu dhënë afat shtesë për dyzet e pesë (45) ditë për të organizuar dhe mbajtur Kuvendin.

Pra, ka njoftuar Selmani, Zyra i rekomandon KQZ-së pezullimin e partisë politike Stranka Demokratske Akcije me akronim SDA në përputhshmëri me nenin 6 të Rregullës së lartpërmendur. Zyra, menjëherë pas Vendimit të KQZ-së për pezullim do të shënojë pezullimin në regjistrin e partive politike duke cekur se regjistrimi i saj është pezulluar dhe do t'i dorëzojë Kryetarit të Partisë vendimin e KQZ-së mbi pezullim, ka thënë në raportin e ZRPP-së për KQZ-në, Valmira Selmani.

Sami Kurteshi: E lexova, kemi pasur këso probleme ! Ne, nuk jemi në vit zgjedhor, pra po propozoj: “A ka mundësi që gjitha subjektet të thirren me një takim, dhe Zyra të komunikoj e të diskutoj dhe të shoh se a janë freskuar të dhënat e tyre, të diskutohen problemet, ato teknike etj.?”

Valmira Selmni, tha se subjektet politike e kanë obligim bashkëpunimin me zyrën në këto çështje, kurse zyra e ka obligim që të organizoj së paku tri takime në vit ku diskutohen shumë çështje, dhe ju rikujtohen subjekteve obligimet e tyre ligjore... Me subjektin në fjalë, nuk kemi mundur të vendosim asnjë komunikim, në asnjë mënyrë dhe mjet...

Čemailj Kurtiši: Mendoj se KQZ, ka komunikim të mirë, sidomos me ato që janë serioze dhe ato e dinë se kur duhet mbajtur takimet, kuvendet, çka duhet bërë, cilat janë obligimet e tyre me KQZ-në etj. Ndonjë parti nuk ka anëtarësi, nuk ka mundësi të mblidhet, nuk ka kushtet...Mendoj që ne komunikojmë në nivel...! Ata, kanë afat 45 ditë, kanë kohë të mjaftueshme...! Tash, unë jam që të jemi fleksibil, por jo përtej...

Në këtë temë, diskutuan edhe: Fazli Stollaj, Sami Hamiti, tha se ky është precendet, por ligji është ligj...! Është një momentum, është shtye dy herë....duhet të procedojmë më tutje, është me ligj e përcaktueme...Alim Rama, tha se duhet të jemi konsistent, ti japim edhe një shansë...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për rekomandimin e zyrës ?

Me 8 për, dhe 3 abstenime, u miratua rekomandimi i ZRPP-së për pezullimin e partisë politike “Stranka Demokratske Akcije” (SDA).

4. Raport i Këshillave të KQZ-së:

2.1 Këshilli për Çështje Ligjore

2.1 Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për kandidatin e radhës për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për zëvendësimin e deputetes znj. Vafije Blair, nga SP LVV:

Sami Hamiti: Në mbledhjen e këshillit, është trajtuar shkresën nga presidentja. Znj. Vjosa Osmani, një kërkesë e dërguar nga VV për zëvendësimin e deputetes Vafije Bler me kandidatin e radhës Nasuf Bejta. Pra, ne rekomandojmë këtë zëvendësim...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për...?

Me 11 vota për, miratohet ky zëvendësim.

3.1.Këshilli për Operacione Zgjedhore;

3.1 Shqyrtimi dhe miratimi i Agjendës “Punëtori për Identifikimin e Shtyllave dhe Synimeve Strategjike”:

Arianit Elshani: Këshilli, ka shqyrtuar një kërkesë të Sekretariatit për organizimin e një punëtorie lidhur me identifikimin e shtyllave dhe synimeve strategjike në kuadër të përgatitjes së strategjisë së KQZ-së. Është planifikuar të mbahet mes 26 – 28 tetor. Ky projekt, tërësisht mbështetet nga OSBE.

Mbështeten 25 pjesëmarrës. KOZ, rekomandon që kjo punëtori të rekomandohet...

Kreshnik Radoniqi: Me 10 vota për, miratohet projekti dhe agjenda e punëtorisë: “Identifikimi i Shtyllave dhe Synimeve Strategjike”.

Vazhdojmë....

Kreshnik Radoniqi: IFES, ka dërguar një ftesë për datën 14 dhe 15 Nëntor në Tiranë...! Nuk po japë propozim, por Alim Rama ka qenë në Shkup...IFES, e përkrahë...

U vendos me 9 vota për që në këtë takim, të përfaqësojnë: Alim Rama dhe Arianit Elshani.

Po ashtu, e kemi ftesën për një pjesëmarrje në Zvicër, dhe jemi ftuar drejtpërdrejtë unë dhe Burim Ahmetaj. Ftesa, është e definueme....

Kush është për...? Miratohet...

Ne, po ashtu, kemi marrë vendim të shkojmë edhe në Strasburg. Propozimi im, është që dikush të zëvendësohet, jemi përcaktuar pesë vetë, por na kërkohet që të jetë edhe një grua, çështje përfaqësimi...

Gordana Llaban: Unë, kam pasur të shkoj në Afrikën Jugore, por për shkaqe shëndetësore nuk shkoj, por është pyetje edhe në Strasburg. Kam probleme konkrete shëndetësore...

Lidhur me këtë pikë, diskutuan: Sami Hamiti, Alim Rama etj.

Në fund, me 10 vota për dhe një abstenim, u vendos që në Strasburg të marrin pjesë gjashtë persona (shtohet edhe Gordana Llaban).

Arianit Elshani, e informoi KQZ-në për vizitën e KQZ-së në Letoni. Tha se, do të përgatitet një raport, dhe KQZ do të njoftohet detajisht me këtë vizitë...

Një çështje tjetër, është edhe informimi publik ku, ndonëse punohet, nuk bëhet njoftim medial. Po ashtu, protokollin në KQZ, nuk funksionon fare, fare...

Ibrahim Selmanaj, shtroi çështjen e udhëtimeve, edhe në aspektin shëndetësorë, dhe ngjashëm dhe, tha se kjo çështje duhet të rregullohet...

Lidhur me këtë çështje, diskutoi edhe Arianit Elshani, Sami Kurteshi, Ilir Gashi.

(Në vazhdim, mbledhja vazhdoi me dyer të mbyllura...)

Të ndryshme !